



100 Vjet Pavarësi

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Këshilli Drejtues-**

---

**V E N D I M**

**Nr.2231, datë 28.12. 2012**

**Për**

**“Miratimin e Rregullores “Të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga operatorët dhe ofruesit e shërbimeve postare””**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Jonela Kalaja, në mbledhjen e datës 28.12.2012, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

**Miratimin e Rregullores “Per të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga operatorët dhe ofruesit e shërbimeve postare”**

## BAZA LIGJORE:

1. Pika 1 e nenit 6, neni 110, 114 dhe neni 115 i ligjit nr.9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (***ligji nr.9918, i ndryshuar***);
2. Shkronjat ç), f) dhe ii) të nenit 7/1, e vijues të Ligjit nr.8530, datë 23.09.1999 “Për shërbimin Postar në Republikën e Shqipërisë”, (***Ligji nr.8530 i ndryshuar***);
3. Ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”;
4. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP (***Rregullorja e Brendshme***), miratuar me Vendim nr. 170, datë 24.04.2004 të Këshillit Drejtues të ERT-së, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 62 të Ligjit 102/2012;
5. Vendimi nr. 2195, datë 19.11.2012 i Këshillit Drejtues të AKEP “Miratim për Këshillim Publik të Projekt-Rregullores “Të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga operatorët dhe ofruesit e shërbimeve postare”;

## KËSHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë nga:

- Projekt Vendimi;
- Relacioni shoqërues i Projekt-Vendimit;
- Qendimin i AKEP mbi komentet e palëve të interesuara;
- Akti Administrativ “*Rregullore per të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga operatorët dhe ofruesit e shërbimeve postare*”;
- Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke i’u referuar bazës ligjore të sipërcituar,

## VËREN:

1. AKEP, me Vendimin nr. 2195, datë 19.11.2012 të Këshillit Drejtues “Për miratim për Këshillim Publik të Projekt-Rregullores “Të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga operatorët dhe ofruesit e shërbimeve postare”, ka publikuar projekt aktin administrativ për palët e interesuara;
2. AKEP, më datë 6.12.2012, fton palët e interesuara në një seancë dëgjimore për të parashtruar mendimin e tyre mbi dokumentin rregullator të publikuar për Këshillim Publik;
3. Këshillimi Publik u krye nga datë 19.11.2012 deri më 19.12.2012, palët e interesuara Operatori Publik Posta Shqiptare sh.a., Ofruesit e Shërbimit Postar, DHL International (Albania) sh.p.k., Albania Courier sh.p.k., kanë depozituar

- brenda afatit kohor, komentet dhe mendimet të cilat i kanë parashtuar edhe në seancën dëgjimore të organizuar nga AKEP;
4. AKEP, në zbatim të nenit 110 të ligjit nr. 9918, dt. 19.05.2008 i ndryshuar, pas përfundimit të afatit për këshillim publik, duke marrë në konsideratë komentet e palëve të interesuara, publikon qëndrimin e tij mbi komentet e palëve, sipas dokumentit bashkëlidhur;
  5. Rregullore “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga operatorët dhe ofruesit e shërbimeve postare”, është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor përkatës, duke patur parasysh dhe implementuar objektivat rregullatorë të AKEP,

### **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Këshilli Drejtues, bazuar në neni 110, 114 dhe 115 të ligjit nr. 9918, i ndryshuar me ligjin nr. 102/2012, datë 23.10.2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S:**

1. Miratimin e Rregullores “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga operatorët dhe ofruesit e shërbimeve postare”, dhe publikimin e qëndrimit të AKEP mbi komentet e palëve të interesuara sipas dokumentit bashkëlidhur;
  2. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP [www.akep.al](http://www.akep.al);
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë me miratimin e tij.

**K R Y E T A R I**

**Piro XHIXHO**

### **ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:**

1. Alban KARAPICI
2. Alketa MUKAVELATI
3. Benon PALOKA
4. Zamira NURÇE



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

# **R R E G U L L O R E**

**Nr. 28, datë 28.12.2012**

**PËR**

**TË DHËNAT STATISTIKORE DHE FINANCIARE  
PERIODIKE MBI SHËRBIMET E OFRUARA NGA  
OPERATORËT DHE OFRUESIT E  
SHËRBIMEVE POSTARE**

*Miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 2231, Datë 28.12.2012*

## **KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

### **Neni 1 Objekti**

Objekti i kësaj rregullore është përcaktimi i të dhënave statistikore dhe financiare periodike për shërbimet postare të ofruara nga operatorët dhe ofruesit e shërbimeve postare, si dhe përcaktimi i procedurave dhe rregullave për plotësimin dhe dërgimin e formulareve me të dhënat e kërkuara.

### **Neni 2 Qëllimi**

Grumbullimi, evidentimi dhe përdorimi i të dhënave statistikore dhe financiare mbi shërbimet postare, për të nxjerrë përfundimet e nevojshme për analizën dhe tendencat e zhvillimit në tregun postar si dhe përcaktimin e treguesve matës të sektorit postar.

### **Neni 3 Baza ligjore**

Gërma ç), f) dhe ii) të nenit 7/1, e vijues të Ligjit nr.8530, datë 23.09.1999 “Për shërbimin Postar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe nenit 10 i Rregullores nr.21, “Për Licencën e Përgjithshme për Ofrimin e Shërbimeve Postare”, i miratuar me Vendim nr. 1532, datë 18.03.2011 të Këshillit Drejtues të AKEP.

### **Neni 4 Fusha e zbatimit**

Dispozitat e kësaj rregulloreje janë të detyrueshme për tu zbatuar nga të gjithë operatorët dhe ofruesit e shërbimeve postare të pajisur nga AKEP me licencë për ofrimin e shërbimeve postare, të cilët bëjnë pjesë në regjistrin sipërmarrësve të publikuar në faqen zyrtare të AKEP, [www.akep.al](http://www.akep.al).

### **Neni 5 Përcaktime**

Termet e përdorura në këtë Rregullore do të kenë të njëjtin kuptim si në ligjin nr.8530, datë 23.09.1999 “Për shërbimin Postar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe akteve të UPU.

**KREU II**  
**PROCEDURA DHE KUSHTET E PLOTËSIMIT DHE DËRGIMIT TË TË**  
**DHËNAVE STATISTIKORE POSTARE**

**Neni 6**

**Detyrimet për plotësimin dhe dërgimin e të dhënave**

1. Çdo operator dhe ofrues i shërbimeve postare, i përcaktuar sipas nenit 4 të kësaj rregulloreje, është i detyruar të plotësojë dhe dërgojë online formularët me të dhënat e kërkuara sipas procedurave, kërkesave dhe afateve të përcaktuara në këtë rregullore.
2. Formularët me të dhënat e kërkuara plotësohen tek Moduli i Aplikimeve Online për të dhënat statistikore dhe financiare postare në faqen e internetit të AKEP: [www.akep.al](http://www.akep.al)

**Neni 7**

**Formularët**

1. Formularët me të dhënat statistikore dhe financiare periodike, që duhet të plotësojnë dhe dërgojnë operatorët dhe ofruesit e shërbimeve postare, janë pjesë e kësaj rregulloreje, të cilat janë të emërtuara si më poshtë:
  - a) **Shtojca 1**- Formular me të dhëna për shërbimet postare të cilat plotësohen dhe dërgohen nga Operatori Publik Postar;
  - b) **Shtojca 2** - Formular me të dhëna për shërbimet postare të cilat plotësohen dhe dërgohen nga Ofruesit e Shërbimeve Postare.

**Neni 8**

**Afatet e dërgimit të të dhënave**

1. Të dhënat e kërkuara sipas formularëve të specifikuar në nenin 7 të kësaj rregulloreje duhet të dërgohen në AKEP sipas përcaktimeve:
  - a) Të dhënat statistikore dërgohen dy herë në vit. Brenda datës 30 Shtator të çdo viti, dërgohen të dhënat për 6 (gjashtë) mujorin e parë të vitit kalendarik aktual, për periudhën Janar-Korrik dhe brenda datës 31 Mars të çdo viti, dërgohen të dhënat vjetore të vitit kalendarik paraardhës, për periudhën Janar – Dhjetor.
  - b) Të dhënat financiare dërgohen një herë në vit. Brenda datës 31 Mars të çdo viti, dërgohen të dhënat financiare vjetore të vitit kalendarik paraardhës, për periudhën Janar – Dhjetor.

**KREU III**

**VERIFIKIMI DHE PËRDORIMI I TË DHËNAVE**

**Neni 9**

**Verifikimi i të dhënave nga AKEP**

1. AKEP, jep konfirmimin, nëse të dhënat e dërguara nga operatori ose ofruesi i shërbimeve postare janë në përputhje të plotë me kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore.

Konfirmimi bëhet online brenda 7 (shtatë) ditëve nga data që janë dërguar në AKEP, të dhënat e kërkuara.

2. Nëse AKEP, konstaton parregullsi në plotësimin dhe dërgimin e formularëve, ose të dhënat statistikore postare nuk janë të plota ose të sakta, brenda 5 (pese) ditëve nga depozitimi i të dhënave, i kërkon operatorit ose ofruesit të shërbimeve postare dërgimin e plotë dhe të saktë të të dhënave.

Ridërgimi i të dhënave duhet të bëhet brenda 10 (dhjete) ditëve, pas marrjes së njoftimit nga AKEP.

3. AKEP, mund të kryejë verifikime të saktësisë të të dhënave të dërguara nga operatori ose ofruesi i shërbimeve postare, nëpërmjet inspektimit të dokumentacionit në ambjentet e tyre.

### **Neni 10** **Përdorimi i të dhënave nga AKEP**

1. AKEP, do të bëjë përpunimin dhe analizën e të dhënave statistikore të dërguara nga operatorët ose ofruesit e shërbimeve postare, të cilat do të shërbejnë për:
  - a) Mbikqyrjen dhe monitorimin e vazhdueshëm të tregut të shërbimeve postare në Shqipëri, me qëllim plotësimin e objektivave rregullatore si dhe politikës sektoriale postare;
  - b) Nxjerrjen e përfundimeve të nevojshme për analizën e situatës dhe tendencave të zhvillimit të tregut postar;
  - c) Publikimin e raporteve periodike që evidentojnë treguesit kryesore të zhvillimit të tregut postar;
  - d) Informimin e institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare, të interesuar për zhvillimin e tregut postar në Shqipëri.
2. AKEP, zbaton parimin e kofidencialitetit në publikimin dhe përdorimin e të dhënave të tregut të shërbimeve postare, në zbatim të ligjit.

## **KREU IV** **KUNËDRVAJTJET ADMINISTRATIVE**

### **Neni 11** **Sanksionet**

Mosrespektimi detyrimeve të përcaktuara në këtë rregullore, nga operatorët dhe ofruesit e shërbimeve postare, bazuar në pikën 5 të nenit 32, të ligjit nr.8530, datë 23.09.1999, i ndryshuar, konsiderohet kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në masën që përcaktohet në germën c) pika 1 e nenit 33 të ligjit nr. 8530.

**KREU V**  
**DISPOZITA TË FUNDIT**

**Neni 12**  
**Publikimi**

Kjo Rregullore, si dhe çdo ndryshim i saj i miratuar nga Këshilli Drejtues i AKEP, publikohet në faqen zyrtare të AKEP.

**Neni 13**  
**Hyrja në Fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi me miratimin e saj me Vendim nr. 2231, dt. 28.12.2012, të Këshillit Drejtues të AKEP.



# AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE



SHTOJCA 2: Plotësohet nga Ofruesit e Shërbimeve Postare

## TË DHËNA PËR SHËRBIMET POSTARE TË OFRUARA PËR PERIUdhËN (dd/mm/viti-dd/mm/viti)

1	Të dhënat për Ofruesin e Shërbimeve Postare	
1.1	Emri i Personit (juridik/fizik):	
1.2	Adresa:	
1.3	Telefon/Fax:	
1.4	E-mail:	
1.5	NIPT-i:	
1.6	Data e regjistrimit ne QKR:	
1.7	Emri i përfaqësuesit ligjor të personit (juridik/fizik):	
1.8	Numri personal sipas dokumentit të identifikimit -ID:	
1.9	Personi i kontaktit:	

2 TREGUESIT E SHËRBIMEVE EKSPRES					
	Emri i Treguesit / Indikatorit	Njësia matëse, copë			
		Postë brenda vendit		Ndërkombëtare	
		Pranuar	Dorëzuar	Pranuar	Dorëzuar
2.	Dërgesa Ekspres				
2.1	Dërgesa të korrespondencës (Dok., Shtypshkrime etj.)				
2.2	Pako / Koli				
2.3	Postë Direkte				
2.4	<b>Totali (2.1+2.2+2.3)</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

3 REZULTATET FINANCIARE			
	Emri i Treguesit / Indikatorit		
		Në Lek	Komente
3.1	Të ardhurat		
3.1.1	Sherbime postare Ekspres	0.00	
3.1.2	Sherbime postare te tjera	0.00	
3.1.3	<b>Totali i të ardhurave (3.1.1+3.1.2)</b>	<b>0.00</b>	
3.2	Shpenzime	0.00	
3.3	Rezultati (3.1-3.2)	0.00	
3.4	Rezultati neto (pas tatimit)	0.00	
3.5	Investime	0.00	

**SHËNIM:** \*) Në fund të Shtojcës 2, tek rubrika “Komente Shtesë” specifiko shërbimet postare të tjera

4	TREGUESIT TEKNIK DHE TË RRJETIT		
	Emërtimi i Treguesit / Indikatorit	Numër / copë	Komente
4.1	Zyra postare të hapura për publikun		
4.1.1	Zyra shërbimi të përhershme të menaxhuara nga personeli i ofruesit të shërbimeve		
4.1.2	Zyra shërbimi të përhershme të menaxhuara nga persona jashtë personelit të ofruesit të shërbimeve-Agjent Postar		
4.1.3	<b>Totali (4.1.1+4.1.2)</b>	<b>0</b>	
4.1.4	Zyra postare jo të hapura për publikun (Qendra Përpunimi)		
4.2	Numri i automjeteve të transportit		
4.2.1	Automjete të rënda (Kamion transportues)		
4.2.2	Furgona		
4.2.3	Vetura		
4.2.4	Motoçikleta/Biçikleta		
4.2.5	<b>Numri i automjeteve për transport në dispozicion, Totali (4.2.1+...+4.2.4)</b>	<b>0</b>	

5	CILESIA / STANDARDET E REALIZIMIT TË SHËRBIMEVE POSTARE						
	Emërtimi i Treguesit/ Indikatorit	Koha e dorëzimit/shpërndarjes së dërgesave					Nr. dërgesave në total
		<i>D + 1*</i>	<i>D + 2</i>	<i>D + 3</i>	<i>D + 4</i>	<i>D &gt; 4</i>	
5.1	Numri i Dërgesave Ekspres						

**SHËNIM:** \*) (D+n) D - dita e pranimit të dërgesave ; n (1,2,3,4) - ditët brenda të cilave janë dorëzuar/shpërndarë dërgesat

6	TË PUNËSUARIT	
	Emërtimi i Treguesit/Indikatorit	Totali
6.1	Numri i të punësuarve me kohë të plotë	
6.2	Numri i të punësuarve me kohë të pjesëshme	
6.3	Numri total i të punësuarve (6.1+6.2)*	
6.4	Numri i korrierëve / shpërndarësve	
6.5	Numri i femrave të punësuar	

**SHËNIM:**


\*) Për të llogaritur numrin e të punësuarve, llogarisni numrin e personave që punojnë me kohë të plotë plus numrin e personave që punojnë me kohë të pjesëshme të konvertuar në punonjës me kohë të plotë. Për shembull, dy persona që punojnë 50% të kohës llogariten si një i punësuar me kohë të plotë.

7	ANKESAT E PËRDORUESVE ( REKLAMACIONET)	
	Ankesat nga përdoruesit e shërbimeve postare	Totali
7.1	Numri i ankesave të pranuar	
7.2	Numri i ankesave të zgjidhura	
7.3	Shuma e dëmit të kompensuar (Lek)	

**Data:**

**Nënshkrimi dhe vula:**

**KOMENTE SHITESË**



# AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE



**A K E P**  
 AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE  
 ELEKTRONIKE DHE POSTARE

SHTOJCA 1: Plotësohet nga Operatori Publik Postar

## TË DHËNA PËR SHËRBIMET POSTARE TË OFRUARA PËR PERIUdhËN (dd/mm/viti-dd/mm/viti)

1	Të dhënat për Operatorin Publik Postar	
1.1	Emri i Personit Juridik:	
1.2	Adresa:	
1.3	Telefon/Fax:	
1.4	E-mail:	
1.5	NIPT-i:	
1.6	Data e regjistrimit ne QKR:	
1.7	Emri i përfaqësuesit ligjor të personit juridik:	
1.8	Numri personal sipas dokumentit të identifikimit -ID:	
1.9	Personi i kontaktit:	

2	TREGUESIT DHE EVIDENCA E REALIZIMIT TË SHËRBIMEVE POSTARE				
	Emri i Treguesit / Indikatorit të shërbimeve postare	Njësia matëse, copë			
		Postë brenda vendit		Postë ndërkombëtare	
		Pranuar	Dorëzuar	Pranuar	Dorëzuar
2.1	Dërgesa të thjeshta				
2.1.1	Letra të thjeshta				
2.1.2	Kartëpostale				
2.1.3	Paketa të vogla				

2.1.4	Shtypshkrime				
2.1.5	Thasë M				
2.1.6	Postë Direkte				
2.1.7	Dërgesa të thjeshta, Totali (2.1.1+...2.1.6)	0	0	0	0
2.2	Dërgesa të regjistruara/shërbime speciale	0	0	0	0
2.3	Pako-Koli				
2.3.1	Pako të thjeshta				
2.3.2	Pako me vlerë dhe kundërpagesë				
2.3.3	Pako, Totali (2.3.1+2.3.2)	0	0	0	0
2.4	Shërbime të Urdhërpagesave				
2.4.1	Urdhërpagesa postare (UPP)				
2.4.2	Urdhërpagesa telegrafike (UPT)				
2.4.3	Urdhërpagesa, Totali (2.4.1+2.4.2)	0	0	0	0

<b>3</b>	<b>TREGUESIT E SHËRBIMEVE EKSPRES</b> (EMS-Express Mail Service)				
	Emri i Treguesit / Indikatorit	Njësia matëse, copë			
		Postë brenda vendit		Ndërkombëtare	
3.	Dërgesa Ekspres	Pranuar	Dorëzuar	Pranuar	Dorëzuar
3.1	Dërgesa të korrespondencës (Dok., Shtypshkrime etj.)				
3.2	Pako / Koli				
3.3	Postë Direkte				
3.4	Totali (3.1+3.2+3.3)	0	0	0	0

<b>4</b>	<b>TREGUESIT PËR TË ARDHURAT</b>			
	Emri i Treguesit / Indikatorit			
4.1	Të ardhurat	Në Lek	Komente	
4.1.1	Posta e Letrave			



4.1.2	Posta e Pakove		
4.1.3	EMS		
4.1.4	Shërbime Financiare		
4.1.5	Filateli		
4.1.6	Shërbime të tjera*		
4.1.7	<b>Totali i të ardhurave (4.1.1+...4.1.7)</b>	<b>0.00</b>	
4.2	Shpenzime	0.00	
4.3	Rezultati (4.1-4.2)	0.00	
4.4	Rezultati neto (pas tatimit)	0.00	
4.5	Investime	0.00	

**SHËNIM:** \*) Në fund të Shtojcës 1, tËk rubrika "Komente Shtesë" specifikoj shërbimet e tjera

5	TREGUESIT TEKNIK DHE TË RRJETIT		
	Emërtimi i Treguesit / Indikatorit	Numër / copë	Komente
5.1	Zyra postare të hapura për publikun		
5.1.1	Zyra shërbimi të përhershme të menaxhuara nga personeli i operatorit		
5.1.2	Zyra shërbimi të përhershme të menaxhuara nga njerëz të caktuar jashtë personelit të operatorit postar-Agjent Postar		
5.1.3	Zyra të lëvizshme që ofrojnë shërbime		
5.1.4	Zyra vetëm për shërbime financiare		
5.1.5	<b>Totali (5.1.1+..+5.1.4)</b>	<b>0</b>	
5.1.6	Zyra postare jo të hapura për publikun (Qendra Përpunimi)		
5.2	Numri i sporteleve për shërbime Universale		
5.2.1	Të automatizuar/kompjuterizuar		
5.2.2	Të paautomatizuar		

5.2.3	<b>Totali (5.2.1+5.2.2)</b>	0	
5.3	<b>Numri i automjeteve të transportit</b>		
5.3.1	Automjete të rënda (Kamion transportues)		
5.3.2	Furgona		
5.3.3	Vetura		
5.3.4	Motoçikleta/Biçikleta		
5.3.5	<b>Numri i automjeteve për transport në dispozicion, Totali (5.3.1+...+5.3.4)</b>	0	
5.4	Kuti postare (publike) për pranim të dërgesave		
5.5	Kuti Postare (Post Box) për dorëzim të dërgesave		

6	CILESIA / STANDARDET E REALIZIMIT TË SHËRBIMEVE POSTARE					
Emërtimi i Treguesit/Indikatorit	Koha e dorëzimit/shpërndarjes së dërgesave					Nr. dërgesave ne total
	D + 1*	D + 2	D + 3	D + 4	D > 4	
6.1	Numri i Dërgesave jo Ekspres					
6.2.	Numri i Dërgesave Ekspres					
6.3	<b>Totali (6.1+6.2)</b>					

**SHËNIM:** \*) (D+n) D - dita e pranimit të dërgesave ; n (1,2,3,4) - ditët brenda të cilave janë dorëzuar/shpërndarë dërgesat

7	TË PUNËSUARIT	
	Emërtimi i Treguesit/Indikatorit	Totali
7.1	Numri i të punësuarve me kohë të plotë	
7.2	Numri i të punësuarve me kohë të pjesëshme	

7.3	Numri total i të punësuarve (7.1+7.2)*	
7.4	Numri i postierëve /shpërndarësve	
7.5	Numri i femrave të punësuar	

**SHËNIM:**


\*) Për të llogaritur numrin e të punësuarve, llogarisni numrin e personave që punojnë me kohë të plotë plus numrin e personave që punojnë me kohë të pjesëshme të konvertuar në punonjës me kohë të plotë. Për shembull, dy persona që punojnë 50% të kohës llogariten si një i punësuar me kohë të plotë.

8	ANKESAT E PËRDORUESVE ( REKLAMACIONET)	
	Ankesat nga përdoruesit e shërbimeve postare	Totali
8.1	Numri i ankesave të pranuar	
8.2	Numri i ankesave të zgjidhura	
8.3	Shuma e dëmit të kompensuar (Lek)	

Data:

Nënshkrimi dhe vula:

KOMENTE SHITESË







## **AUTORITETI KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

### **QËNDRIMI I AKEP MBI KOMENTET E PALEVE TË INTERESUARA PËR DOKUMENTIN:**

**“Rregullore për të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga operatorët dhe ofruesit e shërbimeve postare”**

*(Këshillimi Publik nga data 19.11.2012 deri 19.12.2012)*

**Tiranë më 28.12.2012**

Në përfundim të procesit të këshillimit publik nga data 19.11.2012 deri në datën 19.12.2012 për dokumentin **“Projekt Rregullore për të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga operatorët dhe ofruesit e shërbimeve postare**, miratuar me VKD nr.2195, datë 19.11.2012, nga palët e interesuara kanë derguar komente në AKEP:

- o Operatori A - me email datë 18.12.2012;
- o Operatori B - me shkresë nr.2089/4, datë 17.12.2012 (prot AKEP);
- o Operatori C - me email datë 11.12.2012.

Në këtë dokument paraqitet qëndrimi i AKEP për komentet e palëve të interesuara mbi projekt rregulloren e nxjerrë për keshillim publik:

**A. Komentet dhe propozimet e ardhura në lidhje me afatet e deklarimit të të dhënave statistikore dhe financiare të përcaktuara në nenin 8 të Rregullores, paraqiten si më poshtë vijon:**

**Operatori A – Koment:**

“Operatori A” parimisht shprehet dakort me dokumentin e publikuar për këshillim publik, dhe në lidhje me afatet e deklarimit të të dhënave propozon që:

1. *Të dhënat statistikore të raportohen çdo tre muaj, përkatësisht në muajin Prill, Korrik, Tetor Janar të çdo viti.*
2. *Të dhënat financiare të raportohen dy herë në vit me mbylljen e bilancit gjashtë mujor dhe vjetor.*

**Operatori B – Koment:**

“Operatori B” propozon që afatet e dërgimit të të dhënave duhet të jenë të ndryshme për të dhënat statistikore (operacionale) dhe të dhënat financiare:

1. *Te dhënat statistikore duhet të dorëzohen çdo 6 muaj. Brënda datës 30 Shtator të çdo viti, dërgohen të dhënat për 6 mujorin e parë të vitit kalendarik aktual, për periudhën Janar – Qershor dhe brenda datës 31 Mars të çdo viti, dërgohen të dhënat vjetore të vitit kalendarik paraardhës për periudhën Janar – Dhjetor.*

2. Të dhënat financiare duhet të dorëzohen nje herë në vit. Brenda datës 31 Mars të çdo viti, dërgohen të dhënat vjetore të vitit kalendarik paraardhës për periudhën Janar – Dhjetor.

*Kjo ndarje bën që të dhënat financiare të jenë të sakta, sepse të dhënat financiare 6 mujore nuk janë 100% të sakta në zërin e tatimit mbi fitimin, i cili llogaritet në fund të vitit. Gjithashtu të dhënat vjetore financiare janë edhe lehtësisht të verifikueshme me instancat e tjera, ndërsa në qoftë se do të jenë 6 mujore, duhet që të konsolidohen 2 gjashtë mujorë dhe kjo jo vetëm e vështirson verifikimin por rrit edhe mundësinë e gabimit.*

### **Operatori C – Koment:**

“Operatori C” propozon për ndryshim të nenit 8 të Rregullores:

*Dërgimi i të dhënave duhet të bëhet një herë në vit, sepse për ne nuk është e mjaftueshme koha fizike për të marrë të dhënat në kohë reale si dhe datat e caktuara përkojnë me sezone shumë të ngarkuara me punë.*

### **Qëndrimi i AKEP:**

AKEP duke marrë në konsideratë propozimet e operatorëve dhe ofruesve të shërbimit postar vlerëson se afatet kohore të dërgimit të të dhënave, të përcaktuara në nenin 8 të dokumentit për këshillim publik, të ndryshohen si më poshtë vijon:

a) Të dhënat statistikore duhet të dorëzohen çdo 6 muaj. Brenda datës 30 Shtator të çdo viti, dërgohen të dhënat për 6 mujorin e parë të vitit kalendarik aktual, për periudhën Janar – Qershor dhe brenda datës 31 Mars të çdo viti, dërgohen të dhënat vjetore të vitit kalendarik paraardhës për periudhën Janar – Dhjetor.

b) Të dhënat financiare duhet të dorëzohen nje herë në vit. Brenda datës 31 Mars të çdo viti, dërgohen të dhënat vjetore të vitit kalendarik paraardhës për periudhën Janar – Dhjetor.

Ndërsa në lidhje me propozimin e Operatorit A, që të dhënat sipas formularit të deklarohen cdo tre muaj, AKEP e çmon të arsyeshme që afati i raportimit të jetë sipas rregullimit të mesipërm, në mënyrë që AKEP të përmbushë objektivat në përputhje me ligjin nr. 8530, i ndryshuar si dhe operatorët dhe ofruesit e shërbimeve postare të kenë kohën e nevojshme për përpunimin dhe dërgimin e saktë të të dhënave.

### **B. Koment i ardhur në lidhje me pikën 3 të nenit 9 të Dokumentit për Këshillim Publik, ku përcaktohet se:**



*“AKEP, mund të kryej verifikime të saktësisë të të dhënave të dërguara nga operatori ose ofruesi i shërbimeve postare, nëpërmjet inspektimit të dokumentacionit në ambientet e tyre”.*

### **Operatori B – Koment:**

“Operatori B” propozon që neni 9 të ndryshojë si më poshtë vijon:

*“AKEP, në mënyrë që të verifikojë saktësinë e të dhënave të dërguara, mund të kërkojë informacione shitesë dhe dokumente justifikuese nga operatori ose ofruesi i shërbimeve postare, dokumente të cilat mund të verifikohen nga AKEP në bashkëpunim me institucionet e tjera shtetërore”.*

### **Qëndrimi i AKEP:**

*AKEP, mbi verifikimin e të dhënave të Operatorit Publik Postar dhe Ofruesve të Shërbimeve Postare, vlerëson se përcaktimet në nenin 9 të dokumentit për Këshillim Publik, janë në përputhje me pikën 1 dhe 2 të nenit 18, të ligjit nr. 8530, i ndryshuar. AKEP, për këtë arsye çmon që neni 9 i Rregullores të mbetet i pandryshuar.*

## **C. Koment të ardhur në lidhje me “Shtojca 2 – Rezultatet financiare”:**

### **Operatori C – Koment:**

“Operatori C” propozon:

*Në Shtojcën 2 – Tabela 3 “Rezultatet financiare”, duhet të riformulohet dhe një herë për të dhënat financiare të kërkuara, sepse “shpenzimet” nuk mund të paraqiten me të dhënat si “të ardhurat” si dhe të dhënat si “rezultati neto pas tatimit” nuk mund të jepen, sepse mendojmë se ka një mbivendosje kompetencash me organet tatimore.*

### **Qëndrimi i AKEP**

AKEP vlerëson se, nuk është në kushtet e mbivendosjes së kompetencave, pasi informacioni i kërkuar është i nevojshëm për performancën e funksioneve të rregullimit të tregut dhe bizneseve të shërbimeve postare, për të përmbushur qëllimin dhe objektivat rregullatorë, të përcaktuar nga ky ligj,

duke garantuar ruajtjen sekretit për informacionin e dhënë, në zbatim të nenit 7/1 të ligjit nr. 8530 i ndryshuar.

Për këtë arsye AKEP çmon që përcaktimet në Shtojcën 2 – Tabela 3 “Rezultatet financiare”, të mos ndryshojnë.

#### **D. Komente të ardhura në lidhje me terminologjinë e përdorur në Formularët - Shtojca 2.**

##### **Operatori B – Koment:**

- a) “Operatori B” propozon që zërat në Tabelën 2 - Shtojca 2, duhet të ndryshojnë në përputhje me terminologjinë ndërkombëtare të shërbimit Express, të përcaktuar si më poshtë:

##### **Për Tabelën 2 – Shtojca 2:**

- 2.1 Nga “*Dërgesa të korrespondencës*”(Dok., Shtypshkrime, etj) të ndryshojë në “*Dokumente*”  
Në botë njihen si: Documents
- 2.2 Nga “*Pako / Koli*” në “*Jo – Dokumente*”  
Non - documents
- 2.3 Nga “*Postë Direkte*” në “*Shërbime brenda vendit*”  
Domestic
- b) Disa ndryshime janë të nevojshme edhe në përshkrimet më poshtë sipas pikave të Tabelës 3, Tabelës 4 dhe Tabelës 6, të Shtojcës 2:

##### **Për Tabelën 3 – Shtojca 2**

- 3.1.1 “*Shërbime Postare Express*” të ndryshojë në “*Shërbime Express*”
- 3.1.1 “*Shërbime Postare të tjera*” në “*Shërbime të tjera*”

##### **Për Tabelën 4 – Shtojca 2:**

- 4.1 “*Zyra postare të hapura për publikun*” në “*Zyra shërbimi të hapura për publikun*”
- 4.2 “*Agjent Postar*” në “*Agjent*”
- 4.1.4 “*Zyra postare jo të hapura për publikun*” në “*Zyra jo të hapura për publikun*”  
ose “*Qendra Përpunimi*”

## **Për Tabelën 6 – Shtojca 2:**

6.4 “Numri i postierëve/shpërndarësve”

në “Numri i korrierëve/shpërndarësve”

### **Operatori C – Koment:**

*Gjuha e përdorur në tabelë të rishikohet sepse operatorët jopublik (ofruesit e shërbimeve postare) kanë terminologji tjetër nga ajo e operatorit publik postar.*

### **Qëndrimi i AKEP**

AKEP, në lidhje me propozimin për ndryshimin e terminologjisë në zërat e përcaktuar në Tabelën 2, Tabelën 3, Tabelën 4 dhe Tabelën 6, të Shtojcës 2, vlerëson se në zbatim të nenit 3 “Përkufizimet”, të ligjit nr. 8530, i ndryshuar të meren në konsideratë ndryshimi i zërave në terminologji në tabelat e sipërcituara, pa cënuar përcaktimet e përkufizimeve në ligjin nr. 8530, i ndryshuar, sipas përcaktimeve të mëposhtme:

1. Në pikën 6.4 të Tabelës 6, të Shtojcës 2, në kolonën “Emri i treguesit/indiktorit” ndryshon dhe bëhet: **“Numri i korrierëve/shpërndarësve”**.